



STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 16 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) PUNON ME NDERMARRJET E QIRADHENIES SE MAKINAVE PER TE PERMBUSHUR NEVOJAT E KONSUMATOREVE

Më shumë se 12,000 makina u rivendosën në zonën metropolitane të Nju Jorkut

5,000 të tjera janë duke ardhur

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut është duke punuar me ndërmarrje të qiradhënies së makinave për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve dhe për t'u siguruar se banorët e Nju Jorkut nuk mbeten pa opsione të udhëtimit pas Uraganit Sendi (Sandy). Sipas udhëzimit të Guvernatorit, Departamenti i Shtetit ka lehtësuar rivendosjen e më shumë se 12,000 makinave në zonën metropolitane të Nju Jorkut dhe 5,000 automjete të tjera janë duke ardhur. Ky veprim do të ndihmojë të rehatojë ata banorë të Nju Jorkut makinat e të cilëve u dëmtuan ose u shkatërruan nga Uragani Sendi (Sandy).

“Uragani Sendi (Sandy) la shumë banorë të Nju Jorkut pa automjetet tek të cilat mbështeshin për punë dhe funksionet e përditëshme,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Ndërmarrjet e qiradhënies së makinave janë duke u përpjekur të përmbushin kërkesën e lartë për makina dhe të ndihmojnë konsumatorët që të kthehen në jetën e tyre të përditëshme. I përgëzoj për reagimin e shpejtë të tyre dhe u bëj thirrje ndërmarrjeve të tjera të qiramarrjes në Nju Jork që të bashkohen me përpjekjet tona të rimëkëmbjes.”

Enterprise Holding - pronar i Enterprise Rent-A-Car, National Car Rental dhe Alamo Rent A Car – ka njoftuar publikisht se po rivendos më shumë se 12,000 makina shtesë në zonën metropolitane të Nju Jorkut dhe 5,000 të tjera janë duke ardhur për të ndihmuar në përmbushjen e nevojave për udhëtim të konsumatorëve të prekur nga Uragani. Gjatë disa javëve të kaluara, ndërmarrjet gjithashtu kanë qënë në gjendje të përpunojnë më shumë se 26,000 qiramarrje të makinave të lidhura me sigurimin për t'u shërbyer nevojave të konsumatorëve. Ndërmarrje të tjera të qiramarrjes së makinave priten që të ndjekin këtë shembull.

Përveç kësaj, Shoqata Amerikane e Qiradhënies së Makinave (ACRA) është duke bashkërenduar me Zëvendës/Sekretarin e Departamentit të Shtetit, Markos Vixhil për t'u siguruar se dhjetëra mijëra

Albanian

makina e kamionë janë rivendosur në pjesën lindore sa më shpejt që të jetë e mundur.

Divizioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve gjithashtu ka marrë njoftime se ndërmarrjet e qiradhënies janë duke kërkuar më shumë para për qiramarrjen e automjeteve nga konsumatorët, të cilët kanë nevojë më dëshpërim për automjete zëvendësuese për të shkuar në punët ose destinacionet e tyre. Divizioni do të mbikqyrë nga afër këto ankesa dhe do të vazhdojë bashkërendimin me industrinë e qiradhënies së makinave për t'u siguruar se konsumatorët janë duke u trajtuar ndershmërisht dhe me shpejtësi.

Konsumatorët që janë duke përjetuar vështirësi në marrëdhëniet me ndërmarrjet e qiradhënies së makinave mund të paraqesin një ankesë të konsumatorit pranë Divizionit të Mbrojtjes së Konsumatorit nëpërmjet internetit në <http://www.dos.ny.gov/consumerprotection/> ose duke telefonuar në 1- 800-697-1220.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418